

Drejtuar: Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë.

Bashkia Mallakastër,

Rruga "Mehmet Shehu" 9308,
Ballsh, Shqipëri.

Për dijeni:

Znj. Vasilika Hysi - Kuvendi i Shqiperise

Znj. Senada Mesi - Qeveria e Shqiperise

Z. Bernd Borchardt OSCE Presence in Albania

Z. Donald Lu US Embassy Tirana

Z. Duncan Norman British Embassy Tirana

Z. Matthew Holliday International Commission For Missing Persons (ICMP)

Znj. Romana Vlahutin EU Delegation Albania

Znj. Susanne Schütz German Embassy Tirana

Z. Walter Glos Fondacioni Konrad-Adenauer Tirana

09 Nëntor 2017

Lënda: Kerkese per shfuqizimin e vendimit nr. 27 date 29.05.2002, pika III, Të miratoje emertimin e rrugeve si meposhte: 2. Rruga në drejtim te K.P.TH.N-se "*Rruga Mehmet Shehu*" dhe riemertimin e kesaj rruge, me nje emertim të denjë, për pasqyrimin e vlerave më të mira, të qytetareve të Ballshit, Mallakastrës por edhe gjithë Shqiperise.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 139 / 2015 Per Qeverisjen Vendore.

Ligji Nr. 10221, datë 4.2.2010 PËR Mbrojtjen Nga Diskriminimi.

Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 48 i Kushtetutes së Republikës së Shqiperise.

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).

Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ).

Statuti i Romës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar (Statuti i Romës) parashikon krimin e zhdukjes me forcë, si një krim kundër njerëzimit.

Derguar: Me poste elektronike: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al

I nderuar Z. Migjen Skënderi, Kryetar i Keshillit Bashkiak,

I nderuar Z. Agron Kapllanaj, Kryetar i Bashkisë,

Ne, Adrian Kati (Tiranë), Avis Gjyshja (Miçigan USA), Elida Hysenbregasi (Greqi), Filip Guraziu (Shkoder) , Ilirjan Blloshmi (New Jersey, USA), Ina Kasimati (Tiranë) , Isuf Peposhi (Tirane), Keda Kaceli (Itali), Kujtim Cekani (Gjermani), Osmon Kaceli (Durrës), Valdete Emiri Kreshpa (Tiranë) dhe Dritan Dema, i lindur në Gurëz Kruje, me banim në Mbretërinë e Bashkuar, i indentifikuar me Kartë Identiteti Nr.031165785, me deshiren e mire dhe vullnetin e palëkundur, të motivuar dhe frymëzuar nga dashuria për vendin tonë, me pergjegjësi dhe vetedije qytetare, ju parashtrojme, si vijon:

- Nga Preambula e Kushtetutës së Shqipërisë, citojmë:

“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit”.

1. Rrethanat e çeshtjes:

Me emailin e dates 18 Tetor 2017 jemi informuar nga ana Juaj sa vijon:

“Mehmet Shehu ka qene ish Kryeministri i Shqipërisë ne vitet 1950 - 1981, Origjina e tij vjen nga Fshati Çorrush i Mallakastres”.

Me pas, me emailin e dates 20 Tetor 2017, jemi njohur me vendimin: *“nr. 27 date 29.05.2002, pika III, Te miratoje emertimin e rrugeve si meposhte: 2. Rruga në drejtim te K.P.TH.N-se “Rruga Mehmet Shehu”, duke na konfirmuar gjithashtu se, nuk gjendet relacioni perkates, mbi motivin e ketij sugjerimi.*

2. Mungesa e drejtësisë, nga mosgjykimi i Krimeve Kundër Njerezimit.

Informacioni i meposhtëm i ardhur në rrugë zyrtare nga autoritetet publike, tregon për Krime Kundër Njerezimit, të urdhëruara apo kryera në bashkepunim, nga ish Byroja Politike e Komitetit Qendror Të Partise së Punës së Shqipërisë, ku propozuesi i këtyre krimeve, na rezulton të ketë qene, drejtpersedrejti, i emertuari i rruges Tuaj, Mehmet Shehu.

Më poshtë do të gjeni ekstrakte, të marra nga dokumenti i mbledhjes së Byroës Politike të PPSH-së dt. 20.02.1951, e nxjerre nga F.14/AP OU, V. 1951, D. 1, fl.228 (e bashkangjitur) ku ndër të tjera, citohet:

“Seanca e mbremjes e dates 20 Shkurt 1951 dhe mbeten vetem Anetaret e Byroës Politike të KQ. (bashkangjitur):

Shoku Mehmet Shehu:

“.. pavaresisht nese eshte ndonje nga ata qe mendojme ne apo jo ne duhet te zbulojme pa tjetër burimin dhe njerezit e ketij atentati.

.. eshte e nevojshme politikisht qe te marrim masa represive te jashtzakonshme pa marre parasysh ligjet në fuqi.

*Nje mase te tille e kemi marre edhe kur u vra Bardhok Biba, dmth, **kemi pushkatuar edhe jashte ligjeve në fuqi.***

Une mendoj se masa qe duhet te marrim te jete ne nje shkalle te tille qe elementi qe perpunohet, elemnti reaksionar i tipit kacaruhe etj. sonte ti arrestojme.

Te arrestojme rreth 100 ose 150 veta nga te cilet 10 ose 15 veta ti pushkatojme, duke zgjedhur sigurisht nga ata me kryesoret mbasi kane dashur te organizojne atentate te tjera.

Kjo mase do te procedohet edhe me nje mase tjetër spastrimi nga Tirana të familjeve reaksionare brenda nje muaji.

Ne duhet terrorit ti pergjigjemi me terror dhe kete mund ta bejme me plot ndergjegje dhe gjakftohtesi. Ne i kemi pergatitur listat e arrestimeve dhe po te jeni edhe ju dakord veprojme qe sonde”.

=====

“..Shoku Begir Balluku. Po per çeshtjen e atyre qe do te pushkatojme ne duhet te gjejme edhe nje motivacion.

Shoku Mehmet Shehu: “**kete gje e lidhim me ate qe donim te bënim në 8 Shkurt”.**

Shoku Komandant: Motivacioni të mos thuhet per atentat.

Shoku Mehmet Shehu – Per kete gje duhet te flitet pak edhe me gjykatën dhe prokurorinë ushtarake.

(Mbyllet seanca e dates 20.02.1951)

3. Të pushkatuarit pas vendimarrjes së sipercituar të dates 20.02.1951.

- | | | |
|------------------|----------------------|---------------------|
| 1. Ali Qorrailiu | 8. Jonuz Kaceli | 15. Petro Konomi |
| 2. Anton Delhysa | 9. Lluka Rashkoviç | 16. Pjerin Guraziu |
| 3. Fadil Dizdari | 10. Manush Peshkepia | 17. Qemal Kasoruho |
| 4. Gafur Jegeni | 11. Mehmet Shkupi | 18. Reiz Selfo |
| 5. Gjon Temali | 12. Myftar Jegeni | 19. Sabiha Kasimati |
| 6. Haki Kodra | 13. Niko Lezo | 20. Tefik Shehu |
| 7. Hekuran Troka | 14. Pandeli Nova | 21. Thoma Katundi |
| | | 22. Zyhdi Herri |

4. Konfirmimi i mesiperm i Byrose Politike të K.Q. P.P.SH. i referohet faktit te varjes ne litar te 4 personave dhe pushkatimit te 10 të tjereve, me date 17 Gusht 1949, e cila njihet si “Masakra e Valmirit”, të Mirdites:

1. Bardhok Dode Gjini-Prosek
2. Dode Marka Biba- Kthelle
3. Frrok Mata-Kacinar
4. Gjergj Beleshi-Kthelle (Vritet per te vellane)
5. Gjoke Gjini Kaci-Bukmire
6. Llesh Gjon Melyshi-Malaj.
7. Ndoc Gjon Cupi-Blinisht
8. Ndoc Mark Ndoj-Kacinar
9. Nikoll Llesh Bajraktari-Orosh
10. Nikoll Bardhok Bajraktari-Orosh
11. Pjeter D.Vila- Kacinar

- 12.Pjeter Koka - Kacinar
- 13.Preng Ded Kola-Orosh
- 14.Preng Shkurt Nikolli-Orosh.

5. Baza Ligjore per gjykimin e Krimeve Kunder Njerezimit:

Kodi Penal i Republikes se Shqiperise në Nenin 74, parashikon:

Neni 74 Krime kundër njerëzimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

"Vrasjet, zhdukja me forcë, shfarosjet, kthimi në skllëvër, internimet dhe dëbimet, si dhe çdo lloj torture ose dhune tjetër njerëzore, të kryera, sipas një plani konkret të paramenduar, ose në mënyrë sistematike, kundër një grupi të popullsisë civile, për motive politike, ideologjike, raciale, etnike e fetare dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm".

Neni 67 i Kodit Penal, Mosparashkrimi i ndjekjes penale, parashikon:

"Nuk i nënshtrohen parashkrimit të ndjekjes penale krimet e luftës dhe ato kundër njerëzimit".

Neni 281 i Kodit të Procedures Penale, ndër te tjera, parashikon:

"1. ..Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijëni për një veprë penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore"...

Neni 300 i Kodit Penal, Moskallëzimi i krimit, Parashikon:

"Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.."

Neni 4 Mosnjohja e ligjit, parashikon:

"Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme".

LIGJ Nr.10 221, datë 4.2.2010 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Neni 1 Objekti:

"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Neni 3 Përkufizimet

1. "Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

6. Arsytimi i kërkeses tonë:

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, Anëtarë të Këshillit Bashkiak Mallakaster,

Lligji Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE, Neni 54 **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, ka parashikuar:

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

*"I) **Vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë**".*

Së pari, vendimi i Keshillit Bashkiak Mallakaster i vitit 2002, për të emërtuar këto rrugë, në qytetin e Ballshit, ka rezultuar i gabuar. Nga mungesa e dokumentacionit të plote e kemi të pamundur për të vlerësuar shkaqet që kanë çuar Keshillin e atëherëshëm të bëjë këto vendimarrje e cila mund të ketë qene edhe si rezultat i mosnjohjes apo mosvleresimit të drejte, të fakteve të sipercituara.

Së dyti, dokumentet që ju kemi vene ne dispozicion janë prova, të cilat faktojnë se Mehmet Shehu në bashkëpunim, me anetare të tjere të Byroze Politike, kanë urdheruar kryerjen e ketyre Krimeve Kunder Njerezimit, të cilat kanë rezultuar në vrasjen e të pakten, ketyre 36 qytetarëve të pafajshëm, vetëm në këto dy raste të sipercituara. Këto dy raste janë vetëm "maja e akullnajës".

Me dhjetëra mijëra qytetare të tjere, gra, femije, pleq, janë detyruar të lënë shtëpitë e tyre, shumë prej të cilave janë djegur, pas debimeve dhe internimeve të tyre.

Se treti, Fëmijet e ketyre personave të pushkatuar, ndër të cilët edhe firmetarë / perkrahes të kesaj kerkese, edhe sot i kanë të dashurit e zemres, babadharet e tyre, duke u prere në varre masive.

“40 vjet më vonë, i kemi gjetur në një gropë të lidhur me tela me gjemba” - shprehej një qytetar i nderuar, babai i të cilit gjendej në mesin e 22 të pushkatuarve të 26 Shkurtit, të vitit 1951.

Diktatura e rregjimit komunist nuk kurseu as vete iniciatorët dhe bashkepunetorët e saj. Jemi në dijeni që në vitin 1981 i emertuari Juaj, u gjet i vrare në rrethana të mistershme. Më pas familjaret e tij u persekutuan politikisht nën dhunen e diktatures.

Së katerti, Në njerën anë kemi familjaret e autorit të Krimeve Kunder Njerezimit, që janë nderuar nga Bashkia, me emertimin e kesaj rruge, në anen tjetër kemi familjaret e 36 martireve, viktimave të pafajshme, që prehen në dy varre masive, që janë diskriminuar dhe vazhdojnë të diskriminohen, nga kjo vendimarrje.



Foto 15 Shtator 2017: Nga Autoriteti i Dosjeve, prane varrit masiv ku prehen trupat e Martirëve të Shkurtit 1951.

Ligji ka parashikuar qarte se:

"Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës

së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Prandaj, vendimi i Bashkise Mallakaster per emertimin e mesiper perben diskriminim, dhe eshte në kundërshtim me Ligjin Per Mbrojtjen Nga Diskriminimi.

Eshte në tagrin dhe detyren funksionale të Keshillit Bashkiak Mallakaster, per marrjen e të gjitha masave të menjehershme ligjore, per ndalimin e menjehershem te diskriminimit, duke vendosur ndryshimin e kerkuar.

7. Personat e Internuar dhe personat e zhdukur:

Vetem në Bashkine Tuaj rezultojne te zhdukur 77 persona, pjesa me e madhe e tyre, rezulton te jene zhdukur gjate viteve te rregjimit të diktatures.

Sipas, marreveshjes se 'Statutit të Romes', e nenshkruar dhe pranuar nga Republika e Shqiperise, çdo person i zhdukur, duhet trajtuar si veper penale, Krim Kunder Njerëzimit.

Në ushtrim të së drejtes se informimit, në muajin Shtator 2017, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) ka informuar se:

Vetem në Kampin e Tepelenës gjatë periudhes 1945 - 1954 (9 vjet) jane debuuar dhe internuar:

Nr. i të internuarve në Kampin e Tepelenës afersisht:	3380 persona:
Fëmijë:	1163 fëmijë
Gra:	1254 gra
Burra:	963 burra

Nr. Rendor	Mosha e fëmijës	Numri i Fëmijëve
1	0 - 1 Vjeç	121 fëmijë
2	1 - 2 Vjeç	77 fëmijë
3	2 - 3 Vjeç	71 fëmijë
4	3 - 4 Vjeç	61 fëmijë
5	4 - 5 Vjeç	61 fëmijë
6	5 - 6 Vjeç	85 fëmijë
7	6 - 7 Vjeç	84 fëmijë

8	7 - 8 Vjeç	80 fëmijë
9	8 - 9 Vjeç	88 fëmijë
10	9 - 10 Vjeç	78 fëmijë
11	10 - 11 Vjeç	86 fëmijë
12	11 - 12 Vjeç	70 fëmijë
13	12 - 13Vjeç	55 fëmijë
14	13 - 14 Vjeç	72 fëmijë
15	14 Vjeç	74 fëmijë
16	Mosha nga 0 deri në 14 vjeç	1163 fëmijë

8. Raporti i Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Keshillit të Evropës në kujtesë të krimeve të bera nga rregjimet totalitare në Evropë, ndër të tjera citojne:

"Drejtësia për viktimat është e rëndësishme për tranzicion të suksesshëm nga totalitarizmi në demokraci".

- Gjykimet e autorëve,
- mekanizma të kërkimit të së vërtetës,
- hapjen e arkivave,
- procedurat e lustracionit,
- rehabilitimin dhe kompensimin e viktimave dhe kthimin e pronave të konfiskuara, janë ndër mjetet kryesore për arritjen e këtij objekti".

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52010DC0783>

9. Mohimi i krimeve gjate rregjimeve totalitare, duhet te percaktohet Veper Penale.

Në Dekretin Nr. 1018 date 13.02.1995, të Presidentit të Shqipërisë, citohet,

"U hiqen the gjitha Dekoratat dhe titujt e nderit, per aktin criminal te genocidit, te ushtruar ndaj popullit shqiptar gjate viteve te diktatures komuniste, personave te ish nomenclatures se larte komuniste: Enver Hoxha, Nexhmije Hoxha, Shefqet Peçi, Hysni Kapo, Gogo Nushi, Spiro Koleka, Haki Toska, Haxhi Lleshi"

Në vazhdim, dy Rezolutat e Kuvendit te Shqiperise:

E para, në Tetor 2006, Rezoluta: "Për dënimin e krimeve te kryera nga rregjimi komunist në Shqipëri" dhe

E dyta, në Nëntor 2016, Rezoluta: "Për dënimin e krimeve te komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçante për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve ne mbrojtjen e vlerave demokratike dhe te drejtave dhe lirive themelore te njeriut".

Me 30 Maj 2016 Kontrolli i Larte i Shtetit nxori vendimin PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS, "REHABILITIMI I ISH- TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT"
http://www.klsh.org.al/web/te_perndjekurit_politik_2592.pdf

Keto jane vetem disa nga veprimet konkrete dhe iniciativat ligjore të ndermarra nder vite nga Autoritetet Shqiptare.

10. Në thirrje të ndergjegjes Tuaj morale dhe njerezore:

Te dashur vellezer dhe motra qe perfaqesoni vullnetin e qytetareve te nderuar të Mallakastres. Zonja dhe Zoterinj:

Adrian Yzeiraj, Armelin Agaj, Astrit Zeqiraj, Baftjar Bakiu, Bujar Hazizaj, Etilda Dishaj, Fatjon Nazera, Fitim Baraj, Kliton Aliaj, Laureta Metaj, Migjen Skënderi, Marsela Ahmetaj, Martin Hasani, Niko Ymeraj, Pajtim Ismailaj, Përparim Bengaj, Përparim Metaj, Robert Brahaj, Sabire Hoxhaj, Xhafer Osmënaj, Xhemil Hoxha, Zhaneta Beqaj.

Ju të nderuar 22 Anëtarët e Këshillit Bashkiak Bashkiak Mallakaster, pa dallim bindje politike, feje, krahine apo tjeter:

- Me kete kerkese ju kemi evidentuar se vendiamrrja e kolegeve Tuaj, vite më pare ka rezultuar në emertimin e nje personi qe ka kryer Krime Kunder Njerezimit.

Per nje moment ne duam qe ju te reflektoni:

- 22 jeni Ju, 22 ishin edhe ata bijë dhe bija nënash e babadharësh që i emertuari i rruges Tuaj, dhebashkepundetoret e Tij, jua prene rinine / jeten e tyre për gjysmë.

Lind pyetja:

- A mund ta imagjinoni veten Tuaj në rrethanat dhe pozitat e 22 te arrestuarve te Shkurtit 1951?
- A mund ta imagjinoni veten per nje moment në mesnaten e erret te 20 Shkurtit 51, duke u arrestuar, duke u ndare forcerisht nga gruaja, fëmija, nëna, babai, motra, vëllai, duke most e lejuar as tu jepnit, perqafimin e fundit?
- A mund ti magjinoni turturat, kercenimet, rrahjet, dhunimet, per rreth nje jave rresht, dhe në nje nate te erret dergimin forcerisht, të dhunuar çnjerezisht dhe pushkatuar pa i bere gje askujt?
- A mund ti imagjinoni femijet Tuaj të rriteshin jetimë, të internoheshin, te vuanin per buken e gojes, nënat tuaja të mbesnin pa djemte dhe vajzat e tyre, te perbuzeshin dhe te persekutoheshin per 40 vjet me radhe?
- A e imagjinoni dot se si jane ndjere dhe si ndihen edhe sot familjaret e tyre kur pas 40 vitesh i kane gjetur te gjithë se bashku, 22 Martiret, të lidhur me tela në nje gropë massive?

Keto qe kemi parashtruar me lart ngjajne me nje film horror, por në realitet janë jete dhe vuajtje njerezish, disa prej tyre edhe nenshkrues te kesaj kerkese.

Ne besojmë se në ushtrim të pergjegjesive dhe kompetecave Tuaja ligjore, ju do ta lexoni me kujdes dhe me vemendjen që kerkohet, shkresen tonë.

Ne shpresojme që Bashkia Mallakaster dhe Keshilli Bashkiak do te jenë në lartesine e detyrës, në perzgjedhjen e nje emertimi te ri per kete rruge, emertim i cili do te perfaqesojë më së miri: vlerat e qytetareve te Ballshit, të Mallakastres, të Qarkut të Fierit, ne perputhje me vlerat tona mbareshqiptare, si dhe qellimin dhe objektivin tone kombetar, per tu bere pjese e Bashkimit Evropian, sa me shpejt qe te jete e mundur.

Në mungesë të një pergjigje pozitive nga ana Juaj, brenda nje afati te arsyeshem kohor, ne rezervojme te drejten per t'ju drejtuar me nje ankese Komisionerit Per Mbrojtjen Nga Diskriminimi, njekohesisht edhe autoriteteve të tjera ligjore dhe diplomatike, si dhe mediave kombetare dhe nderkombetare, deri në realizimin e plotë te kesaj kerkese.

Faleminderit paraprakisht për vemendjen dhe mbetemi në pritje te pergjigjes Tuaj në rasti e pare te mundshem.

Në bashkëpunim me: Adrian Kati (Tiranë), Avis Gjyshja (Miçigan USA), Dritan Dema (UK), Elida Hysenbregasi (Greqi), Filip Guraziu (Shkoder) , Ilirjan Blloshmi (New Jersey, USA), Ina Kasimati (Tiranë) , Isuf Peposhi (Tirane), Keda Kaceli (Itali), Kujtim Cekani (Gjermani), Osmon Kaceli (Durrës) dhe Valdete Emiri Kreshpa (Tiranë).

Sinqerisht,



Dritan Dema

Kontaktet: Email dritan.dema@gmail.com ose nepermjet telefonit 0044 755 488 4271.

Dokumente të bashkangjitura:

1. Lista e 77 Personave të zhdukur, nga Mallakastër, e vitit 1996.
2. Dekreti i Presidentit Per Heqje Dekoratash dhe Tituj Nderi.
3. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë Per Denimin e Krimeve Te Rregjimit Komunist 2006
4. Rezoluta e Kuvendit te Shqipërisë per Denimin e Krimeve te Komunizmit ndaj Klerit 2016.
5. Minutat e Mbledhjes se Byrosë Politike 20 Shkurt 1951